VENDIM
Nr. 439, datë 22.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 848, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS SË TENSIONIT TË LARTË 400 KV TIRANË 2-ELBASAN 2, QARKU ELBASAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit nr. 848, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Prona me numër pasurie 363/3, e parashikuar në numrin rendor 14 të listës, numri i shtyllës 87, ndryshohet me pronën me numër pasurie 363/6.

2. Prona me numër pasurie 541, e parashikuar në numrin rendor 16 të listës, numri i shtyllës 88, ndryshohet me pronën me numër pasurie 380/5.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha